INSTRUCTIONS FOR MEDICAL EXAMINATIONS IV/DV/K-1/V-92

Dear visa applicant,

Please read the instructions carefully. All intending immigrants, regardless of age, are required to undergo a medical examination by one of the panel physicians, listed below:

Dr. Dritan & Dr. Elsa Muzha
U.S. Consular Office Panel Physician, Tirana
Boulevard Gjergj Fishta, Nd. 6, H. 9
Njesia Bashkiake 10, Kodi postar 1001
(8-floor tower, green color)
Tirana, Albania
Email: muzha@uspanel-physician-al.com

Dr. Dritan Cela
U.S. Consular Office Panel Physician, Tirana
Rr. Teodor Keko, Pall. Edglis, Kt. 2
Ish Astiri, Unaza e Re
Tirana, Albania
E-mail: cela@uspanel-physician-al.com



Map of Dr. Dritan & Dr. Elsa Muzha's Office (ctrl & click on the map to open the location.)

Map of Dr. Dritan Cela's office and Glob Health Clinic (ctrl & click on the map to open the location.)

Please follow these steps to have a medical appointment scheduled:

Step 1: Obtain the **personal vaccination card** for you and for your family members that are applying for a visa from your Regional Directorate of Public Health.

Step 2: Go to Panel Physicians' website http://uspanel-physician-al.com/ and read the information on how to prepare the required documents for your medical appointment.

Step 3: Three weeks before your interview date, each visa applicant, regardless of age must fill out and submit the medical application form found at http://uspanel-physician-al.com/ under "Apply Now".

Step 4: The panel physician staff will check your medical application form and will send you via email your medical appointment date after three working days you submitted your medical application form.

Step 5: The medical appointment date. On your appointment date, you and your family members (if applicable), regardless of age, will appear on the scheduled time to the panel physician's office. Each of you must submit on your appointment date:

1. Your medical appointment letter;
2. Your passport(s) and copy of passport(s) - adults and children (the originals and a legible photocopy of every passport that will be submitted to our office);
3. Your personal vaccination card(s) and copy of it (the original and a legible photocopy for each card to be submitted to our office);
4. Your interview appointment letter. If you were instructed by the Consular Section to attend the medical without a scheduled interview date, then you must provide panel physician your case number (example: TIA20175556666, or 2017EU00012345). Failure to do so, will result in not being able to complete your medical examination;
5. Six (6) photographs of size 3x4 cm for each person, taken in full-face view directly facing the camera, taken within the last six months;
6. (If applicable) Medical reports that you may have for any surgeries, and/or a prescription from your family doctor of any current medication;

If the aforementioned documents are issued by Albanian authorities (both the originals and the photocopies), then they do not need to be translated or notarized. Failure to submit the complete information requested in the form, or missing/incorrect vaccination card may result in significant delays of your medical examination and your visa interview date. If you failed to submit the correct information, the panel physician staff will ask you to complete any missing information in your medical form, or they will provide you with instructions regarding any missing vaccination(s) for you and your family members. In order to avoid delays, you must be prepared to act promptly on your case by submitting ALL required documents as instructed by the panel physician staff.

WHEN YOU ARRIVE

Note that you may be called slightly earlier or later of your scheduled time, due to individual circumstances of the previous applicant being processed. Please keep quiet and be patient. Please follow the panel physician's staff's guidance. Please note that both you and your family members will need to spend the entire day undergoing various medical examinations first at the panel physician's office, then the Glob Health Clinic, and after that back at the panel physician's office. Once the results are available, you will need to sign the medical forms in front of the Panel Physician. The results will be provided to you in a sealed envelope, which you must **NOT** open.

The fee for applicants 15 years and older is $170.00 (includes physical examination, chest x-rays, syphilis, and gonorrhea test.) The fee for children under 15 years of age is $100.00.

In order to assess the health status of the applicant, further examinations may be required in some cases. If this applies to your case, you must follow the panel physician's instructions regarding any additional tests. The applicant is responsible for any additional costs for any such examinations, except for Tuberculosis and Gonorrhea treatment. In order to avoid extra examinations, you should include all

medical reports for any medical issues or illnesses you may have, including any previous blood tests. Pregnant women should have a gynecological ultrasound as well as a complete medical report from their gynecologist where the pregnancy gestation age must be included as well.

Important Notice: In accordance with the Center for Disease Control and Prevention (CDC) instructions, you may be required to undergo additional testing for Tuberculosis (TB), which may take an additional time of 8-10 weeks for the results to become available. The Panel Physician's Office will notify the U.S. Consular Section regarding any applicants referred for further TB culture testing, so that they don't experience any delays on the date of their visa interview. If the applicant's results are TB positive, he or she will need to undergo a compulsory TB treatment by the panel physician's staff.

The results of your medical examination may be released to the applicant only, or directly to the U.S. Consular Section. Only employees of the Consular Section may open the sealed envelope. You **may not** open the envelope. You should not send the chest X-ray CD to the U.S. Embassy, unless you are an asylee. You will be provided with a copy of your vaccination documentation worksheet, which you may need in order to be able to register your child into a U.S. school, etc.

By signing the DS-2054 application, you personally authorize and agree to undergo the medical examination.

Note: The validity of your visa will be limited to the validity of your medical report. Medical reports classified as "Class B (TB)" are valid for 3 months from the date on which the doctor signed the report. All other medical reports classified as "No apparent disease or defect" are valid for 6 months from the date on which the doctor signed the report. If your case is subject to further administrative processing, or if the processing of your file is delayed due to missing documents, the medical report may expire before your visa is issued. In that case, you will be required to renew the examination and submit an updated medical report to the Consular Section before you receive your visa. In such cases, you will be required to pay a new medical examination fee.

The payment for the medical examination will not be refunded, regardless of the result of your visa application. The medical staff is not responsible for ***any*** delays pertaining to the processing of your visa case by the U.S. Consular Section.

VACCINATIONS

On your medical appointment, you (and your family members applying for a visa) must provide to the panel physician your original personal vaccination card containing records of all vaccinations received throughout their entire life. Only the vaccination cards that were issued by the appropriate health centers containing the applicant's name, father's name, surname, birthday, exact vaccination and revaccinations date records are considered valid and acceptable vaccination cards. A personal vaccination card must also have the stamp of the health center, a clearly legible name of the physician together with his or her signature.

Your personal vaccination card is the only document that certifies your vaccination. No other documents will be accepted. <u>If you do not submit your original vaccination card during your medical examination, you will be considered unvaccinated. Any vaccine records for which the receipt dates are not written in or are written in only partially will not be taken into consideration</u>.

Please note: The panel physician staff will guide you on any missing vaccines you must take. During the flu season, each visa applicant is required to administer the flu shot.

If you received any other vaccines, not listed in the list of vaccinations available in Albania, you will be required to provide any such vaccination records to the panel physician's office as well. Note: applicants who have travelled to any of these countries within the last 12 months: Pakistan, Syria, Equatorial Guinea, Afghanistan, Ethiopia, Iraq, Israel, Somalia, or Nigeria, must bring proof of vaccination for Poliomyelitis, and they should inform the panel physician's office of that.

UDHËZIME MBI VIZITËN MJEKËSORE IV/DV/K-1/V-92

I nderuar aplikant i vizës,

Lutemi lexoni udhëzimet me kujdes. Të gjithë aplikantët e vizës emigruese, pavarësisht moshës, duhet t'i nënshtrohen një vizite mjekësore tek një nga mjekët e mëposhtëm:

Adresa 1:
Dr. Dritan Muzha & Dr. Elsa Muzha
Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla 6, Hyrja 9
(Kulla 8 katëshe, jeshile me stemë)
Tiranë, Shqipëri
Email: muzha@uspanel-physician-al.com

Adresa 2:
Dr. Dritan Cela
Rr. Teodor Keko, Pall. Edglis, Kt. 2
Ish Astiri, Unaza e Re
Tiranë, Shqipëri
Email: cela@uspanel-physician-al.com

Adresa e Dr. Dritan dhe Elsa Muzha (crtl&kliko për të hapur hartën e zyrës)

Adresa e Dr. Dritan Cela dhe e Klinikës Mjekësore Glob (crtl&kliko për të hapur hartën e zyrës)

Lutemi ndiqni hapat e mëposhtëm që të merrni një datë takimi për vizitën mjekësore:

Hapi 1: Merrni **kartelën personale të vaksinimit** nga Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik për ju dhe pjesëtarët e familjes që po aplikojnë për vizë imigruese së bashku me ju.

Hapi 2: Vizitoni faqen e internetit http://uspanel-physician-al.com/ dhe lexoni të gjithë informacionin se si të përgatiteni për vizitën mjekësore., duhet të plotësojë formularin.

Hapi 3: Tre javë përpara datës së intervistës për vizë, secili aplikant, pavarësisht moshës**, duhet të plotësojë dhe dorëzojë elektronikisht formularin e tij individual të aplikimit për vizitën mjekësore**, që e gjeni tek http://uspanel-physician-al.com/.

Hapi 4: Stafi i mjekëve do të kontrollojë formularin tuaj mjekësor dhe pas rreth te ditësh pune nga dorëzimi i formularit do ju dërgojë me email datën dhe orën e takimit për vizitën mjekësore. Nëse ju nuk keni dërguar informacionin e plotë, stafi mjekësor do ju udhëzojë që të jepni informacionin e munguar. Për të shmangur vonesat, ju duhet të veproni me shpejtësi duke i dërguar të gjitha dokumentet e kërkuara siç ju ka udhëzuar stafi mjekësor në email.

Hapi 5: Dita e vizitës mjekësore. Në ditën e vizitës mjekësore, ju dhe aplikantët për vizë të familjes suaj, pavarësisht moshës, do të paraqiteni në orarin e caktuar në zyrën e mjekut. Secili prej jush duhet të dorëzojë këto dokumente në ditën e vizitës mjekësore:

1. Fletën e datës së vizitës mjekësore;
2. Pasaportën tuaj dhe kopje të pasaportave – për secilin aplikant të vizës, të rritur dhe fëmijë (Origjinalin/et dhe nga një fotokopje të qartë të tyre, e cila do të dorëzohet tek mjeku).
3. Kartelën/at personale të vaksinimit dhe kopje të saj, për secilin aplikant të vizës (Origjinalin/et dhe nga një fotokopje të qartë të tyre, e cila do të dorëzohet tek mjeku).
4. Fletën e datës së intervistës. Nëse Seksioni Konsullor ju ka udhëzuar të kryeni vizitën mjekësore pa një datë takimi, ju duhet patjetër t'i jepni mjekut numrin e çështjes suaj (p.sh.: Tia 20175556666, ose 2017EU00012345);
5. Për çdo person **gjashtë (6) fotografi** me përmasa 3x4 cm ballore të nxjerra 6 muajt e fundit;
6. Epikriza nga spitali(et) për ndonjë operim që keni kaluar, dhe/ose një përshkrim të mjekimit aktual për sëmundje aktuale që keni, etj.

I gjithë dokumentacioni shqip (origjinalet dhe fotokopjet) nuk ka nevojë për përkthim ose noterizim. Vonesa të gjata në caktimin e datës së vizitës mjekësore dhe të datës së intervistës për vizë mund të ndodhin nëse nuk dërgoni në kohë informacionin e plotë të formularit.

PASI TË KENI MBËRRITUR

Lutemi prisni në radhë dhe mbani qetësi. Ju mund të thërriteni pak më shpejt apo më vonë nga orari i caktuar, në varësi të rrethanave individuale të personit para jush. Ndiqni udhëzimet e stafit mjekësor. Vini re që ju dhe familja juaj do të duhet të kaloni gjithë ditën me vizita mjekësore të ndryshme tek zyra e mjekut, pastaj tek Klinika Mjekësore Glob, e më pas për të firmosur formularët dhe për të marrë zarfin e vizitës mjekësore tek zyra e mjekut. Rezultatet e vizitës do ju jepen në një zarf të vulosur, të cilin ju **NUK** duhet ta hapni.

Tarifa për të rriturit (mosha 15 vjeç e lart) është **170 Dollarë** (në këtë pagesë përfshihet ekzaminimi fizik, radiografia e gjoksit, analizat për sifiliz dhe gonorre). Pagesa për fëmijët nën moshën 15 vjeç është 100 Dollarë.

Gjatë kontrollit mjekësor mund të lindë nevoja për ekzaminime shtesë për të përcaktuar gjendjen shëndetësore. Nëse mjeku do ju kërkojë analiza shtesë për ju, ju duhet të ndiqni udhëzimet e stafit mjekësor. Tarifat për ekzaminimet shtesë janë në ngarkim të aplikantit, përveç trajtimit të Tuberkulozit dhe të Gonorreas. Nëse sëmundja ose problemi shëndetësor njihet paraprakisht, për sqarim nevojiten raportet shëndetësore, epikriza nga kartoteka e spitalit, libreza shëndetësore, analiza, të cilat këshillohet t'i keni me vete për të evituar riparaqitjen ose ekzaminimet shtesë. Gratë shtatzana duhet të kenë me vete ekzaminimin EKO me film dhe përshkrimin nga mjeku gjinekolog të moshës së shtatzanisë.

E rëndësishme: Sipas Udhëzimeve të Qendrës për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (CDC), juve mund t'ju kërkohet t'i nënshtroheni analizave të mëtejshme për Tuberkuloz (TB) ose për gonorrea. Përgjigja

e analizave të TB-së mund të marrë 8-10 javë. Seksioni Konsullor do të njoftohet me listën e aplikanëve të referuar për analizat e TB-së dhe të gonorreas, ndaj ju nuk do të hasni vonesa në ditën e intervistës për vizë. Nëse aplikanti rezulton pozitiv, ai ose ajo do t'i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm të TB-së ose gonorresë nga stafi mjekësor. Ju nuk do të paguani tarifë tjetër për trajtimin e TB-së dhe të gonorresë.

Rezultatet e vizitës mjekësore do t'i dorëzohen në zarf të mbyllur dhe të vulosur vetëm aplikantit, ose Seksionit Konsullor. Ju **NUK mund** ta hapni zarfin. Hapja e zarfit bëhet vetëm nga nëpunësit e konsullatës. Ju nuk duhet ta dërgoni në Ambasadë CD-në e Rrezeve X, përveç rasteve me azil. Juve do ju jepet një kopje e formularit të vaksinave, i cili mund t'ju kërkohet për të regjistruar fëmijën në shkollë, etj.

Me firmosjen nga ana juaj të formularit mjekësor DS-2054 ju personalisht autorizoni dhe pranoni vizitën mjekësore.

Njoftim: Data e skadimit të vizës suaj do të kushtëzohet nga data e skadimit të raportit mjekësor. Formularët mjekësorë të klasifikuar si Class B (TB) janë të vlefshme për 3 muaj nga data që e firmos mjeku. Të gjithë formularët e tjerë të klasifikuar si "Nuk ka sëmundje të dukshme" janë të vlefshëm për 6 muaj nga data që e firmos mjeku. Nëse rasti juaj kalon për proces administrativ të mëtejshëm, apo shqyrtimi i rastit tuaj vonohet për shkak të dokumenteve që mungojnë, raporti mjekësor mund të skadojë përpara se viza të lëshohet. Në këtë rast, juve do ju kërkohet të kryeni edhe njëherë vizitën mjekësore dhe ta dërgoni zarfin mjekësor në Seksionin Konsullor përpara se ju të merrni vizën tuaj.

Pagesa e vizitës mjekësore nuk kthehet pavarësisht nga rezultati i aplikimit tuaj për vizë emigrimi.

Personeli mjekësor nuk mban përgjegjësi për vonesa në lidhje me shqyrtimin e dosjes së aplikantit në Zyrën Konsullore të SH.B.A.-së.

UDHËZIME PËR VAKSINIMIN

Në ditën e vizitës mjekësore, aplikanti kryesor dhe pjesëtarët e familjes për vizë duhet të dorëzojnë kartelat personale të vaksinimit (TË RRITUR DHE FËMIJË), ku do të pasqyrohen imtësisht të gjitha vaksinat që ata kanë bërë që nga fëmijëria dhe deri në ditë e vizitës mjekësore. Kartelat e vaksinimit që pranohen të vlefshme janë vetëm ato që lëshohen nga konsultorët, qendrat shëndetësore dhe drejtoritë rajonale të shëndetit publik. Aty duhet të jenë të dokumentuara emri, atësia, mbiemri i personit, datëlindja e saktë, datat e sakta të vaksinimeve dhe të rivaksinimeve (dita/muaji/viti). Kartelat personale të vaksinimit do të jenë të vulosura me vulën e konsultorit/qendrës shëndetësore/drejtorisë rajonale të shëndetit publik dhe të kenë vulën e mjekut që e lëshon këtë dokument. Vulat dhe emri i mjekut duhet të jenë të lexueshme.

Dokumenti i vetëm që vërteton vaksinimin tuaj është kartela personale tip e vaksinimit. Përveç këtij dokumenti vaksinimi, nuk do të njihet si i vlefshëm asnjë dokument tjetër. **PËR ÇFARËDO LLOJ ARSYEJE** në qoftë se në vizitën mjekësore nuk do të paraqisni kartelën personale të vaksinimit ju do të konsideroheni të pavaksinuar. Në rast se në kartelën personale të vaksinimit janë regjistruar datat e vaksinimit vetëm për disa vaksina dhe vaksinat e tjera janë pa data (ju mund të pretendoni se janë kryer por nuk janë të dokumentuara) këto të fundit do të konsiderohen të pakryera, pra ju do të konsideroheni të pavaksinuar me to.

Kini parasysh: Stafi mjekësor do ju udhëzojë për çdo vaksinë që duhet bërë. Gjatë sezonit të gripit, stafi mjekësor do ju udhëzojë të kryeni vaksinën e gripit (e detyrueshme).

Përveç vaksinave të lartpërmendura ju mund të keni kryer edhe vaksina të tjera jashtë shtetit, të cilat mund të mos kenë hyrë në Shqipëri dhe ju mund t'i keni kryer. Nëse keni dokumentacion zyrtar për to, duhet ta paraqisni gjatë vizitës mjekësore.

Shënim: aplikantët që kanë qenë gjatë 12 muajve të fundit në këto shtete: Pakistan, Siri, Guinea Ekuadoriale, Afganistan, Etiopi, Irak, Izrael, Somali, apo Nigeri, duhet të sjellin prova të vaksinimit për Poliomelit dhe të deklarojnë që kanë qenë në një nga këto shtete pranë stafit mjekësor.